



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18 Shkurt 2022

Nr: 82

V E N D I M

P Ë R

**CAKTIMIN E KOHËS SË TRANSMETIMIT FALAS NË RADIOTELEVIZIONIN PUBLIK
TË FUSHATËS ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE TË REGJISTRUARA SI SUBJEKTE
ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE,
TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ë” e “n”, e 2, dhe 80, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dekretit nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, si dhe vendimit nr. 2, datë 22.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar

V Ë R E N:

Neni 80, pika 1, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se, Radiotelevizioni Publik vë minutazh falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si subjekte zgjedhore për të bërë fushatë zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 80 shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, cakton minutazhin për partitë parlamentare, sipas numrit të vendeve në Kuvend që ato kanë marrë në zgjedhjet e fundit, si dhe për partitë joparlamentare.

Partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i cakton një minutazh falas, të barabartë prej jo

më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta falas, në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike.

Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 (dhjetë) minuta falas, në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike.

Bazuar në nenin 80, pika 1, të sipërcituar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përllogaritur kohën në dispozicion të subjekteve zgjedhore, duke u bazuar në regjistrimin e tyre për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, ku janë regjistruar në total 1 (një) koalicion zgjedhor dhe 3 (tre) parti politike.

Me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, Komisioni Rregullator ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të vitit 2021 për Kuvendin e Shqipërisë, duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga secili subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve të fituara në zgjedhjet e fundit për Kuvend, rezulton se:

- Partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 6 Mars 2022, janë:
 1. Partia Socialiste e Shqipërisë;
 2. Partia Demokratike.
- Parti tjetër parlamentare që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin ka marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe është regjistruar si subjekt zgjedhore për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 6 Mars 2022, është:
 1. Lëvizja Socialiste për Integrim

Duke analizuar nenin 80 pika 1, shkronja “b”, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit, bazuar në parimin e proporcionalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet nga numri i subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar listat për kandidatët për kryetar bashkie. Neni 65, pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se, të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Koalicioni “Shtëpia e Lirisë” ka deklaruar si parti udhëheqëse të koalicionit, Lëvizjen Socialiste për Integrim.

Gjithashtu, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, është regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe partia politike joparlamentare, Lëvizja e Re që konkurren më vete, duhet të përfitojnë 10 (dhjetë) minuta në Televizion dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ë” e “n”, e 2, dhe 80, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, si dhe vendimit nr. 2, datë 22.01.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 60 (gjashtëdhjetë) minutash falas, përkatësisht 30 (tridhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 30 (tridhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore si më poshtë:
 - a) Partia Socialiste e Shqipërisë;
 - b) Partia Demokratike.
2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 30 (tridhjetë) minutash falas, përkatësisht 15 (pesëmbëdhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor, Koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.
3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 20 (njëzet) minutash falas, përkatësisht 10 (dhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike, për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjektit zgjedhor, Lëvizja e Re.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

